



BASHKIA
TIRANË

KRYETARI

VENDIM

Nr. 34399 / datë 22.9 2017

PËR

NDËRMARRJEN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT “QYTETI I GJELBËR” (GCAP) – PËR BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 14, nenit 26, pika 1 dhe nenit 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 5 pika 1.3 shkronja “b”, nenit 13, pika 1 shkronja “b” të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; nenit 58, pikat 1, shkronja “a” dhe pika 3, nenit 72 të vendimit nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”,

VENDOSI:

1. Të ndërmarrë nismën për hartimin e Planit të Veprimit Qyteti i Gjelbër (GCAP) – për Bashkinë Tiranë.
2. Botimin e këtij vendimi në regjistrin e integruar të territorit dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë.
3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion VEELAJ

